



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:197848

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436347

P.nr.990/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **J.K.**, nga Prizreni, me mbrojtësin e tij **av.A:Q.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale Shantazhi nga neni 329 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore te shtetit në Prizren PP.nr.1692-5/2022 të datës 29.09.2023, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Merita Gaka të akuzuarit, mbrojtësit te tije, te demtuares, me datë **29.02.2024**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **J.K.**, nga i ati, e ëma, e vajzerise, i lindur me dt.ne Prizren, ku edhe tani jeton ne rr.pnr, ka te kryer shkollën e mesme, i divorcuar baba i 2 femijeve, punëtor, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 26.07.2022, i pandehuri J.K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër e kanos se do të zbuloj për të dëmtuarën apo personat të afërm të saj që të dëmtoj nderin dhe autoritetin e tyre, i pandehuri e kanos të dëmtuarën se posedon video incizime si dhe foto intime të saj dhe nëse e dëmtuara nuk ja jep 4000.00 (katërmijë) euro i dyshuari të njejtat do të ja dërgoj vëllaut dhe të fejuarit të saj dhe do t'i postoj në rrjetin social “youtube” me qëllim që t’ia dëmtoj nderin dhe autoritetin e saj si dhe familjes.

Me të cilat veprime kishte për të kryer veprën penale të shantazhit nga neni 329 parag. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 dhe neni 329 par.1 të KP-se, si dhe nenit 364 të KPP-se, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ne lartësi prej **300,00 /treqinde/ Euro** të cilën shume të dënimit do të paguaje në afat prej 30 diteve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 Euro një dite burg, respektivisht 15 dite burgim dhe

D E N I M M E K U S H T

Duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 /tre/ muajve** për një vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin ligjor prej **1 viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

I akuzuari obligohet që të paguaje shpenzimet e procedurës penale, dhe atë në emer të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumen prej **20,00 euro**, si dhe në emer të shpenzimeve për kompenzimin e eviktimit të krimit shumen prej **20,00 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 diteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E demtuara L.Q.:, nga Pizreni, rr.banesa e Fat-Grup 5, K-1, H-D nr.2, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën me PP.nr.1692-5/2022 të datës 29.09.2023, kundër të akuzuarit **J.K.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale Shantazhi nga neni 329 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në shqyrtim fillestar ka vërtetuar gjendjen e këtillë faktike nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime, duke u mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 par.2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të KPPK-se, dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës shantazhi nga neni 329 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë dhe me kusht si të merituar, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale-juridike.

Me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke mos e gjetur rrethanat posaçërisht rënduese, si rrethane lehtësuese është marrë pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranimi është bërë vullnetshëm pa ndikim e as presion nga jashtë, në kuptim të nenit 70, 71 e 72 të KP-së gjykata mori për bazë bashkëpunimin vullnetar të të akuzuarit me gjykatën, bashkëpunimi i cili ka të bëjë me hetimin dhe ndjekjen kryerësve të veprave penale, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thelle i tij, kërkim falje publike ndaj të dëmtuarit dhe familjes së saj, gjykata morri për bazë edhe faktin se i akuzuari premtoi që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë dhe me kusht sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jete i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463 parg.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 454 të KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Penal
P.nr.990/2023 të datës 29.02.2024

Sekretare juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:197848
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05436347